



**Qeveria e Republikës së Maqedonisë**  
**Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural**

Në bazë të nenit 9 paragrafi 1 pika 6 nga Ligji për ratifikimin e marrëveshjes sektoriale mes Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Komisionit Evropian për vendosjen e dispozitave për menaxhimin dhe zbatimin e ndihmës financiare të Unionit për Republikën e Maqedonisë sipas Instrumentit për ndihmë në sektorin e politikës për "Bujqësi dhe zhvillim rural" (IPARD) (Gazetar zyrtare e RM nr. 38/2016), në bazë të pjesës II masë të investimeve në mjete financiare të bujqësisë pika 11, masë të investimeve në mjete materiale për përpunimin e prodhimeve bujqësore dhe produktet e peshkut pika 11 masa në Diversifikimin e fermave dhe zhvillimin e biznesit pika 11 nga Programi për përdorimin e mjeteve nga Instrumenti për ndihmë për zhvillim rural në Unionin Evropian (IPARD) për periudhën 2014-2020 (Gazeta zyrtare e RM nr. 177/2016), dhe në bazë të nenit 6 nga dekreti për mënyrën dhe procedurën e shfrytëzimit të mbështetjes financiare për masat për zhvillim rural të financuara nga IPARD 2014-2020 (Gazeta zyrtare e RM nr. 64/2016)

**Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural**  
më 24 prill 2017 shpall  
**THIRRJE PUBLIKE nr. 01/2017**  
për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve nga  
IPARD Programi 2014-2020

1. Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillimin rural (në tekstin e mëtejshëm: Agjencia) si institucion përgjegjës dhe organ kontraktues për zbatimin e Instrumentit për ndihmë qasëse për zhvillim rural të BE (IPARD) ju bën thirrje të gjithë personave fizik dhe juridik të Republikës së Maqedonisë të dorëzojnë kërkesë për shfrytëzimin e mjeteve nga IPARD programi 2014-2020 për masat në vijim:
    1. **Investime në mjete materiale për bujqësi**
    2. **Investime në mjete financiare për përpunimin e prodhimeve bujqësore dhe produktet e peshkut**
    3. **Diversifikimi i fermave dhe zhvillimin e biznesit.**
  2. Mbështetja financiare për këtë Thirrje publike është e përbërë nga 75% mjete të siguruara nga Instrumenti për ndihmë qasëse për zhvillim rural të Bashkimit Evropian (IPARD) në përputhje me Marrëveshjen Financiare 2014-2020 dhe 25% mjete të siguruara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.
  3. **Mjete financiare sipas kërkesës individuale** shpërndahen si mbështetje financiare e pakthyeshme (grant) në shumë prej:
    - 3.1. 60% nga vlera e shpenzimeve të përgjithshme të pranueshme të investimeve për masën "Investime në mjete materiale të bujqësisë". Përqindja rritet deri 65% për investime në bujqësi të propozuara nga bujqit e rinj (person fizik të moshës prej 18 deri 40 vjet në ditën e posedimit të kërkesës për mbështetje financiare) dhe 70% për investime në bujqësi në zonat malore.
    - 3.2. 50% nga vlera e shpenzimeve të përgjithshme të pranueshme të investimeve për masën "Investime në mjete materiale për përpunimin e prodhimeve bujqësore dhe produktet e peshkut".
    - 3.3. 65% nga vlera e shpenzimeve të përgjithshme të pranueshme të investimeve për masën "Diversifikimi i fermave dhe zhvillimin e biznesit".
- Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave është më 23 qershor viti 2017**
- Marrja e formularëve dhe udhëzimet:**
- Formularët e nevojshëm nga "Kërkesa për shfrytëzimin e mjeteve të IPARD Programit 2014-2020 si dhe "Udhëzim për shfrytëzimin e mjeteve nga IPARD Programit 2014-2020" për çdo masë veçmas ku janë përfshirë të gjithë informacionet për kriteret, kushtet për pranimin e projekteve dhe kushtet për financim dhe informacione të tjera të cilat nevojiten për përgatitjen e kërkesës për shfrytëzimin e mjeteve nga IPARD Programi 2014-2020, Udhëzim për përgatitjen e Planit të Biznesit / Propozimi i Projektit Teknik, Udhëzime për dorëzimin e dokumenteve të nevojshme nga institucionet kompetente dhe informacione tjera të dobishme në formë elektronike mund të merren në ueb faqen e Agjencisë: [www.ipardpa.gov.mk](http://www.ipardpa.gov.mk).
- Formularët të shtypura të kërkesës për shfrytëzimin e mjeteve nga IPARD Programi 2014-2020 dhe Udhëzime për përdorues të mjeteve nga IPARD Programi 2014-2020 për çdo masë veçmas mund të merren direkt nga Agjencia në adresë: **Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillimin rural, bul. Brigada e 3të e Maqedonisë nr. 20, (ndërtesa Makedonija Tabak blok C), 1000 Shkup** dhe në qendrat më të afërta rajonale apo njësitë e punës të Agjencisë për nxitjen e zhvillimit në bujqësi me të dhëna për kontakt të cilat janë publikuar në ueb adresën [www.ipardpa.gov.mk](http://www.ipardpa.gov.mk).
- Mënyra për dorëzimin e kërkesës:**

Kërkuesi duhet të plotësojë dhe të dorëzoj Kërkesë për shfrytëzimin e mjeteve nga IPARD Programi 2014-2020 për masë veçmas, Planit të biznesit të përpunuar në përputhje me Udhëzimet për përpunimin e Planit të biznesit apo Propozimi i Projektit Teknik dhe dokumentacion shoqërues siç është përmendur në këtë Thirrje Publike.

Kërkesa e plotësuar për shfrytëzimin e mjeteve nga IPARD Programi 2014-2020 bashkë me Planin për biznes/ Propozimi i Projektit Teknik dhe dokumentacionin e plotë të nevojshëm dorëzohen në zarf të mbyllur me shënim në anën e përparme të zarfit, në anën e majtë sipër "MOS E HAP" për Konkurs publik IPARD numër 01/2017 dhe caktimin e masës për të cilën dorëzohet kërkesa. Kërkesa mund të dorëzohet përmes postës si dërgesë e porositur apo personalisht në arkivin e Agjencisë.

Pas përfundimit të investimit, kërkuesi është i obliguar të dorëzojë deri te Agjencia kërkesë për pagesë në afat të caktuar në Marrëveshjen për shfrytëzimin e mjeteve.

Kërkesë për pagesë është formular i unifikuar të cilin përdoruesit përfundimtar e fitojnë gjatë nënshkrimit të marrëveshjes për mbështetje financiare. Kërkesat për pagesë gjithashtu do të jenë në dispozicion për marrje në hapësirat e Agjencisë dhe në ueb faqen [www.ipardpa.gov.mk](http://www.ipardpa.gov.mk)

**Vërejtje:** Për shkak të kontrollit në teren nga ana e Agjencisë kërkuesi nevojitet të ketë më vete kopje nga dokumentacioni i kompletuar i dorëzuar në Agjencinë.

**Për më shumë informacione në kontakt tel. (02) 3097-460 apo në kontakt e-mail adresën: [ipardpa.info@ipardpa.gov.mk](mailto:ipardpa.info@ipardpa.gov.mk) dhe në ueb faqen: [www.ipardpa.gov.mk](http://www.ipardpa.gov.mk).**